Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
N/Nr. 262/19
Date/Datum 25.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 262/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P."SNR"–Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Newko Balkan L.L.C''-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë'', me nr.prokurimit: KEK-19-292-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/, më datë: 26.06.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T.P. "SNR"–Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë'' me nr. prokurimit: KEK-19-292-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/ .

II. **ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë'' me nr. prokurimit: KEK-19-292-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.T.P."SNR"–Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt: 05.02.2019.
Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 28.03.2019.
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 13.05.2019.
Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshëm është bërë me dt: 15.05.2019.

Data e njoftimit për dhënien e kontratës është bërë me dt: 15.05.2019.
Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 20.05.2019.

Me dt: 22.05.2019, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: N.T.P. "SNR–Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: N.T.P. "SNR–Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.05.2019, me nr.262/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë'', me nr.prokurimit:KEK-19-292-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 57, 59, 65, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 29, 39, 6 F03 të,
  RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.06.2019, ka autorizuar ekspertin profesional te prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit, në raportin e dt: 17.06.2019, sqaron pretendimin e OE ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë sepse Deklaratën ne betim nuk e ka plotësuar si duhet, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
OE i rekomanduar për kontratë të paraqitur në platformën elektronike formularin standard Aneksin 2 te dosjes se tenderit dhe i njëjti është i plotësuar si duhet. I përmban te gjitha te dhënat e nevojshme te operatorit ekonomik. Është i nënshkruar dhe vulosur ne emër te kompanisë dhe si i tille i plotëson kushtet e nevojshme si dokument valid. Si i tille është i pranueshme dhe ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se sigurimi i ofertës se operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate nuk është bere ne përputhje me nenin 57 te LPP-se dhe Aneksin 4 te Dosjes se tenderit sepse sigurimi i nxjerre nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT) i mungojnë kërkesat apo klauzolat e kushteve te konfiskimit te Sigurimit te tenderit. Kjo e bene sigurimin e tenderit te pa realizueshëm për autoritetin kontraktues ne rast te kërkesës se tije për mos përmbushjen e operatorit ekonomik te njërës nga kushtet e specifikuara ne Aneksin 4 te dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues ka ketë mendim.
Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate ka ofruar sigurimin e tenderit nga Banka kombëtare tregtare (BKT) shuma e te cilët është e njëjte me atë te kërkuar ne dosjen e tenderit. Mirëpo sigurimi i tenderit te OE fitues nuk i përmban kushtet e parapara me nenin 57 pika 1 te LPP-se. Te njëjtat kushte janë te parapara edhe ne aneksin 4 te dosjes se tenderit. Këto kushte parashohin rastet kur mundet te behet konfiskimi i sigurimit te tenderit për rastet e caktuara. Fakti qe këto kushte janë vendosur ne dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues, te njëjtat ka qene dashur te përfshihen edhe ne sigurimin e tenderit nga ana e operatoreve ekonomik.
Ne rastet si tani te sigurimi i tenderit te OE fitues kur nuk përfshihen kërkesat e dhëna ne dosjen e tenderit, atëherë neni 57 pika 2 e LPP-se thotë
"Nëseautoritetikontraktuesvendosnjëkërkesëpërsiguriminetenderit,kërkesaetillëdotëaplikohetpërtëgjithëtenderuesit.Autoritetikontraktuesdotërefuzojëdhenukdotëvlerësojënjëtendertëpranuarnganjëtenderuesqënukekapërmbushurkushtinedepozitimittësigurisësëtenderit"
Pra autoriteti kontraktues ka vendosur një kërkesë për sigurimin e tenderit dhe operatori ekonomik ankues kur e ka dorëzuar ofertën me sigurimin e tenderit, i njëjti sigurim nuk e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues (klauzolat për konfiskimin e sigurimit).
Autoritetit kontraktues ka qenë dashtë të eliminoj ofertën e operatorit ekonomik ankues për shkak se Sigurimi i tenderit nuk është ne përputhje me nenin 57 pika 1 të LPP-së.

Po ashtu një rast i tillë është i theksuar edhe te Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nenin 39 (Sqarimi i Tenderëve) ku në tabelë janë dhënë rastet si të veprohet për mungesë të dokumenteve dhe të plotësimit të tyre. Shih tabelën e më poshtme që si arsyetim është marrë edhe nga operatori ekonomik ankues.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57.
Dokumenti i operatorit ekonomik ankues "Sigurimi i tenderit" nuk e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues të dhënë në aneksin 4 të dosjes së tenderit "Sigurimi i tenderit".Prandaj ky pretendim ankimor vlerësohet si i bazuar.

Lidhur me pretendimin e fundit te OE ankues të paraqitura në ankesë autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar neni 72 te LPP-se(Dokumentacioni dhe informacioni shtese) kur ka kërkuar sqarime prej OE fitues lidhur me Deklaratën e specifikimeve teknike, Deklaratën e Liferimit, Deklaratën e Garancionit dhe Deklaratën e Standardit DIN:22102 te cilat deklaratë nga OE fitues janë dorëzuar me numër te prokurimit për një aktivitet tjetër dhe te njëjtat janë plotësuar dhe dorëzuar pas hapjes se ofertave qe bie ndesh me nenin 72 te LPP-se, eksperti shqyrtues ka ketë mendim. Është fakt qe me oferte OE ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklarata e përmendura me lartë për një aktivitet tjetër me nr.KEK-19-125-121, ndërsa gjate procesit te vlerësimit pas kërkesës për sqarim shtesë te bere nga autoriteti kontraktues këto deklarata janë përmirësuar dhe dorëzuar te autoriteti kontraktues tani me numër te këtij aktiviteti te prokurimit KEK-19-292-111. Këtu shihet qartë qe operatori ekonomik fitues ka bere një gabim teknik me rastin e shkrimit te këtyre deklaratave ku nr. i aktivitetit te prokurimit është shkruar tjetër nga ai për te cilin ka konkuruar. Si do qe te jetë, dorëzimi i dokumenteve shtese te cilat mbajnë datën e lëshimit pas hapjes se ofertave është ne kundërshtim me nenin 72 pika 3 te LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i bazuar.

Procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues nuk është bere ne përputhje me neni 59 te LPP-se sepse oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate ka pasur dobësi serioze ne sigurimin e tenderit sepse sigurimi i tenderit te kësaj oferte nuk i ka plotësuar kushtet e nenit 57 te LPP-se dhe nuk ka qene ne përputhje me kërkesat e Aneksit 4 te dosjes se tenderit. Pra ne ketë rast nuk është respektuar neni 57 te LPP-se.
Po ashtu dobësi ka pasur edhe te pranimi i deklaratave te operatorit ekonomik fitues ku te njëjta janë korrigjuar dhe pranuar pas hapjes se ofertave, veprim qe bie ndesh me nenin 72 pika 3 te LPP-se. Bazuar ne përgjigjet e dhëna me larte gjate shqyrtimit te kësaj lende, eksperti shqyrtues e vlerëson si te bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues dhe i rekomandon Panelit Shqyrtues qe ta aprovoj atë.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta bëjë Rivleresimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë" me nr.prokurimiKEK-19-292-111në bazë të dispozitve të LPP-së.

Operatori ekonomik N.T.P."SNR"–Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 18.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues KEK, përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 26.06.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti profesional i prokurimit, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Bajgora deklaroj: Panelit i dorëzoj një parashtrese lidhur me pretendimet tona ankimore dhe kërkoj nga paneli qe ta pranoj lenden tone si te bazuar dhe te hudhe poshte vendimin e Autoriteti Kontraktues gjithashtu panelit i dorëzoj sigurimin e tenderit dhe vendimet e OSHP 373/17, dhe 184/19. Pajtohemi me mendimin ekspertit Shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Bytyqi deklaroj: Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, piken e pare pajtohemi sa i përket deklaratës nen betim ndërsa për pikat tjera nuk pajtohemi, me piken e 2-te ankimore rreth sigurimit te tenderit qe ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontrate ne ia kemi kthyer përgjigjën edhe OE ankues ne kërkesën për rishqyrtim ku do ti paraqesim edhe arsyet tona sigurimi i Tenderit është dorëzuar sipas kërkesave te DT-së, dhe i plotëson kushtet kryesore te kërkuara si: Titullin dhe nr e prokurimit te AP përkatës, shumën e sigurimit prej 130.000 siç është kërkuar afatin e skadences prej 120 ditësh sipas kërkesës se DT dhe për me tepër garantuesi merr përsipër ne mënyre te parevokueshëm e ti paguaj përfituesit çdo shume deri ne lartasin e garancisë sipas kërkesave ne DT. Qëllimi i sigurimit te tenderit është ekzekutimi, sigurimi i tenderit dhe mendojmë qe ky kriter ne sigurimin e tenderit është prezantua tek OE Njufko Ballkan. OE ankues kane thënë qe nuk i plotëson kërkesat e nenit 57 te LPP-së, ku edhe eksperti ju ka referuar neni 57 pika 1 flet për konfiskim te sigurimit te tenderit për informatë përmbajtësish të gabueshme dhe mashtruese te cilat nuk janë vërtetuar dhe nuk ka dëshmi qe ekzistojnë. Për

me tepër kjo garanci është subjekt e rregullave Uniforme për garanci me kërkese (URDG) 2010 revizion publikimi ICC 758. Gjate një shfletimi ne faqen zyrtare t BQK-se kemi gjetur një rregullore për letrën kredinë dhe garancionin bankar ku mes te tjerave i referohen sigurimeve bankare pikërisht me këto rregull qe i përmenda me larte. Panelit i dorëzoj sigurimin tenderit dhe rregulla nga faqja e BQK-se.
Për piken e 2-te ku eksperti i ka pranuar si te bazuar OE ankues ka te bej me deklaratat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues te cilat i ka dorëzuar OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ato deklarata te garantonit, liferimit, dhe deklarata e standardeve është referuar kërkesave tona me Emer OE qe i ka dorëzuar i rekomanduar për kontrate i ka sjelle sipas kërkesave tona ku i ka paraqit emrin e AP kërkesat tona për liferim 40 dite edhe atë e ka paraqit edhe tek garancionin për 3 vite edhe atë e ka ofruar edhe deklaratën e standardeve është ofruar sipas kërkesave tona mirëpo Nr i Prokurimit ka qen lëshim teknik qe e ka sjell për çka edhe e kemi sqaruar këto deklarata OE i rekomanduar na ka kthyer përgjigje para marrjes se vendimit ku ka thënë qe është bere një gabim teknik dhe numri ka mbet një nr tjetër, Eksperti ka thënë se nuk keni pasur te drejt te bëni pyetje sqaruese për ketë çështje qe mendojmë qe Autoriteti Kontraktues ka vepruar drejte sepse ka qen një gabim teknik dhe me eliminuar OE e pare për ketë çështje e me dal te OE i dytë SNR qe ne ketë rast ka qene buxhetit te Korporatës i kishte kushtuar 82.903 euro për me tepër ne kemi vepruar ne harmoni gjate kërkesës se për sqarim neni 59.paragrafi 2 i LPP-së dhe nenin 72 te LPP-së

Gjatë prezantimit në seancë eksperti profesional i prokurimit shqyrtues z. Kurtishaj deklaroj: Pikat bazike te cilat i parash neni 57 i LPP-së, qe kanë te bëjnë me sigurimin e tenderit po ashtu ato pika janë te shkruara ne aneksin 4 te DT-së, për mendimin tim janë obligative dhe detyruese për OE-te qe te parashihen edhe ne sigurinë e tenderit. Sigurimi i paraqitur nga OE fitues nuk i parasheh këto pika prandaj ne raste se paraqitet nevoja për konfiskimin e sigurisë nga Autoriteti Kontraktues ne ketë formë siç është dhen sigurimi i tenderit është e pamundshme te konfiskohet,prandaj jo rastësisht ligji e ka paraparë shume qarte. Sa i përket pikës tjetër Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar sqarime shtesë OE fitues për deklaratën e spec.teknike deklaratën liferimit standardit DIN, fillimisht këto deklarata janë dorëzuar me oferte tjetër te AP, pas dorëzimit janë korrigjuar këto deklarata ne përputhje me AP si te tilla janë pranuar nga Autoriteti Kontraktues çdo dokument i dorëzuar pas hapjes se ofertave me date te me vonshme se data e hapjes se ofertës është ne kundërshtim te nenit 72 pika 2 te LPP-së . Qëndroj prapa raportit te dhen ne ekspertize.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z.Bajgora deklaroj: Kërkojmë te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe te hudhet posht vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Bytyqi deklaroj: Kërkojmë te refuzohet si e pabazuar ankesa e OE-se dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se operatori ekonomik ankues N.T.P."SNR"–Prishtinë, pretendon se OE i rekomanduar për kontratë OE "Newko Balkan L.L.C''- Suharekë, nuk i ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë, sepse Deklaratën ne betim nuk e ka plotësuar ashtu siç duhet.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i pa bazuar për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate, ka paraqitur në platformën elektronike formularin standard Aneksin 2 te dosjes se tenderit dhe i njëjti është i plotësuar siç duhet, ku i përmban të gjitha te dhënat e nevojshme te operatorit ekonomik, është i nënshkruar dhe vulosur ne emër te kompanisë dhe si i tille i plotëson kushtet e nevojshme si dokument valid dhe i pranueshme dhe ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.T.P."SNR"–Prishtinë, se sigurimi i ofertës se operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate OE "Newko Balkan L.L.C''- Suharekë, nuk është bere ne përputhje me nenin 57 te LPP-së, dhe Aneksin 4 te Dosjes se tenderit sepse sigurimi i nxjerre nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT) i mungojnë kërkesat apo klauzolat e kushteve te konfiskimit te Sigurimit te tenderit. Pasi qe sigurimi i tenderit te OE fitues nuk i përmban kushtet e parapara me nenin 57 pika 1 te LPP-së. Te njëjtat kushte janë te parapara edhe ne aneksin 4 te dosjes se tenderit. Këto kushte parashohin rastet kur mundet te behet konfiskimi i sigurimit te tenderit për rastet e caktuara. Obligohet AK KEK qe te kërkoj sqarime shtese për këtë sigurim, pasi që është lëshuar nga Banka e jo nga Kompania e Sigurimeve (sikur te ishte nga Kompania e Sigurimeve nuk do te kishim dilema).

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.T.P."SNR"–Prishtinë, se autoriteti kontraktues KEK, nuk e ka respektuar neni 72 te LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtese) kur ka kërkuar sqarime prej OE fitues lidhur me Deklaratën e specifikimeve teknike, Deklaratën e Liferimit, Deklaratën e Garancionit dhe Deklaratën e Standardit DIN:22102 te cilat deklaratë nga OE fitues janë dorëzuar me numër te prokurimit për një aktivitet tjetër dhe te njëjtat janë plotësuar dhe dorëzuar pas hapjes se ofertave qe bie ndesh me nenin 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar, për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate me oferte ka dorëzuar deklarata e përmendura e cekur me lartë për një aktivitet tjetër me nr.KEK-19-125-121, ndërsa gjate procesit te vlerësimit pas kërkesës për sqarim shtesë të bere nga autoriteti kontraktues këto deklarata janë përmirësuar

dhe dorëzuar te autoriteti kontraktues tani me numër te këtij aktiviteti te prokurimit KEK-19-292-111. Obligohet AK-KEK te vërtetoj qe këto sqarimeve nuk janë ne kundërshtim me nenin 72 pika 3 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nga ana e autoriteti kontraktues KEK, nuk është bere ne përputhje me neni 59 dhe 72 te LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

z. Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK - Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a /KEK/,
1x1 OE - N.T.P."SNR"–Prishtinë,
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.